

RELACION

PËR

AKTIN NORMATIV “PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.8668, DATË 23.10.2000, “PËR PAJISJEN E SHTETASVE SHQIPTARË ME PASAPORTË PËR JASHTË SHTETIT”, TË NDRYSHUAR”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Akti normativ “Për një shtesë në ligjin nr.8668, datë 23.10.2000, “Për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shtetit”, të ndryshuar”, propozohet me qëllim zgjidhjen e problematikave të shtetasve shqiptarë, pjesëmarrjen e gjerë të votuesve nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, që do të regjistrohen në platformën “PER” në zgjedhjet për Kuvendin, dekretuar nga Presidenti i Republikës, me dekretin nr.399, datë 5.12.2024, “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për Kuvendin”, të cilëve u ka përfunduar afati i vlefshmërisë së dokumentit pasaportë.

Nisur nga disa vlerësime dhe të dhëna paraprake, që raportohen nga “Identitek”, sh.a., rezulton informacioni, si më poshtë vijon:

- 435 690 shtetas me të drejtë vote, të cilët disponojnë dokument letërnjoftim elektronik, me vlefshmëri deri në datën 15 maj 2025;
- 209 931 shtetas me të drejtë vote, të cilët disponojnë letërnjoftim dhe pasaportë biometrike, me vlefshmëri deri në datën 15 maj 2025.

Ndërsa për shtetasit me të drejtë vote, të cilëve u ka kaluar afati i vlefshmërisë së dokumentit të identifikimit ose mund t’u skadojë deri në zgjedhjet e 11 majit, janë përafërsisht 523 283 shtetas.

Kjo situatë do të krijonte kufizimin e së drejtës kushtetuese të shtetasve jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për të votuar, arsye për të cilën është propozuar shtyrja e afatit të vlefshmërisë së dokumentit të pasaportës.

Me synim evitimin e pamundësive për votim nga ana e këtyre shtetasve, që do të votojnë nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, konsiderohet e nevojshme ndërmarrja sa më shpejt e hapave të nevojshëm administrativë për të mundësuar që këta shtetas të ushtrojnë të drejtën e votës në zgjedhjet për Kuvendin, që do të zhvillohen në datën 11 maj 2025, duke propozuar zgjatjen e

afatit të vlefshmërisë së dokumentit të pasaportave deri në fund të muajit maj 2025.

Për regjistrimin në platformën “PER” nga shtetasit shqiptarë, që do të votojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, dokumenti pasaportë për jashtë vendit është dokumenti alternativ, krahas letërnjoftimit elektronik, që u mundëson shtetasve identifikimin në ushtrim të së drejtës së votës.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKË

Hartimi dhe miratimi i këtij akti normativ nuk është parashikuar në programin e përgjithshëm analitik të projektakteve që do të paraqiten në Këshillin e Ministrave për Ministrinë e Brendshme, për vitin 2025.

Ky propozim ndikohet si rezultat i situatës aktuale, në të cilën kërkohet mundësimi i së drejtës së votës për të gjithë shtetasit shqiptarë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, të cilët nuk disponojnë pasaportë të vlefshme për zgjedhjet për Kuvendin, që do të zhvillohen në datën 11 maj 2025.

Republika e Shqipërisë u siguron ndihmë shtetasve shqiptarë që jetojnë e punojnë jashtë shtetit për të ruajtur e për të zhvilluar lidhjet me trashëgiminë kulturore kombëtare. Mbrojtja e të drejtave dhe gëzimi “*de facto*” i të drejtave kushtetuese nga migrantët, përfshirë dhe të drejtat politike, ndër to edhe e drejta e votës, përkon pikërisht me paraqitjen e këtij propozimi që ka të bëjë me marrjen e masave shtesë nga organet shtetërore në drejtim të ushtrimit të së drejtës së votës.

Në nenin 3, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, parashikohet:

Çdo shtetas shqiptar, që ka mbushur moshën 18 vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, pa dallim race, etnie, gjinie, gjuhe, bindjeje politike, besimi, aftësie fizike ose gjendjeje ekonomike, ka të drejtë të zgjedhë dhe të zgjidhet, në përputhje me rregullat e parashikuara në këtë Kod.

Çdo zgjedhës ka të drejtën e vetëm një vote për zgjedhjen e një subjekti zgjedhor.

Ndërmjet të tjerash, ligji nr.9668, datë 18.12.2006, “Për emigrimin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi”, i ndryshuar, parashikon si qëllim të tij përkujdesjen, mbrojtjen, ruajtjen e identitetit kombëtar të shtetasve shqiptarë dhe forcimin e lidhjeve me vendin e origjinës. Në bazë të këtij ligji riafirmohet e drejta e migrantëve shqiptarë në gëzimin e të drejtave dhe lirive politike, të parashikuara nga legjislacioni shqiptar, si dhe e drejta për të marrë pjesë aktive në jetën politike të vendit.

Autoritetet përgjegjëse krijojnë lehtësirat e nevojshme në mënyrë që migrantët të ushtrojnë të drejtën e votës në përputhje me legjislacionin në fuqi. Pavarësisht se ligji i drejtohet vetëm një kategorie të migrantëve, atyre që janë larguar për qëllime punësimi, përcaktimi i detyrimit të shtetit për të lehtësuar procesin e votimit nga migrantët është me rëndësi.

Lehtësitë për të votuar duhet t'u krijojnë jo vetëm migrantëve për motive punësimi, por të gjithë migrantëve që janë larguar përkohësisht apo në mënyrë afatgjatë, për sa kohë kanë shtetësinë shqiptare dhe gëzojnë të pashkëputur lidhjen juridike me shtetin shqiptar.

Për sa më lart, vlerësojmë që afati i vlefshmërisë së pasaportës që përfundon deri në datën 11 maj 2025 të zgjatet deri në datën 31 maj 2025 për shtetasit me vendbanim jashtë vendit, pasi këto të fundit qëndrojnë zakonisht ose të shumtën e kohës në një vend të huaj, për shkak të punës apo të shërbimit të përhershëm, të ndodhjes së pasurisë apo të realizimit të interesave të veta atje. Si rrjedhojë, për arsye të ndryshme dhe objektive, rinovimi i mjetit të identifikimit të shtetit shqiptar mund të mos jetë realizuar në kohë prej tyre, shtuar këtu edhe arsyen se numri i veprimeve, për të cilat iu nevojitet një mjet identifikimi i shtetit shqiptar i përditësuar, është më i ulët sesa për shtetasit shqiptarë me banim brenda vendit.

Në këtë drejtim, nga Ministria e Brendshme u paraqit propozimi për këtë akt normativ.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Ky akt normativ synon garantimin e së drejtës kushtetuese për votim, në zgjedhjet për Kuvendin.

Gjithashtu Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr.362, datë 20.1.2025, i është drejtuar Këshillit të Ministrave dhe për dijeni partive politike, që do të marrin pjesë në zgjedhje me qëllim shtyrjen e afatit të vlefshmërisë së dokumenteve të identifikimit.

Kryeministria, me shkresën nr.422/1, datë 27.2.2025, ka përcjellë për ndjekje dhe veprim pranë Ministrisë së Brendshme shkresën nr.362, datë 20.1.2025, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ).

Ndër efektet e pritshme të këtij akti normativ është mundësia për rritjen e numrit të votuesve shqiptarë, të cilët nuk posedojnë pasaportë të vlefshme, për t'u mundësuar në këtë mënyrë ushtrimin e së drejtës së votës në zgjedhjet për

Kuvendin, që do të zhvillohen në datën 11 maj 2025 dhe regjistrimin në platformën “PER”.

Në përmbajtje të këtij relacioni janë pasqyruar të dhënat për shtetasit shqiptarë, të cilëve u përfundon afati i vlefshmërisë së pasaportës, ç’ka sjell në mënyrë evidente nevojën për të mundësuar këtë të drejtë kushtetuese, ku Këshilli i Ministrave, nëpërmjet kësaj nisme, ezauron për një periudhë të shkurtër, hapësirën për shtyrjen e afatit të vlefshmërisë së pasaportave, duke mundësuar kështu të drejtën e votës, shprehjen e vullnetit të shtetasve shqiptarë.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Akti normativ është hartuar në përputhje me Kushtetutën. Neni 101 i Kushtetutës ka parashikuar të drejtën e Këshillit të Ministrave për të nxjerrë akte rregullatore me fuqinë e ligjit. Kjo e drejtë ka natyrë lejuese dhe përjashtimore, prandaj Kushtetuta e ka kushtëzuar ushtrimin e saj me ekzistencën e nevojës dhe urgjencës, si dhe me kontrollin përfundimtar nga Kuvendi të akteve të nxjerra.

Nevoja dhe urgjenca janë elemente me rëndësi të veçantë në përmbajtjen e nenit 101 të Kushtetutës dhe, si të tilla, janë elemente përcaktuese për të drejtën që sanksionon kjo dispozitë. Gjykata Kushtetuese, në disa vendime të saj, përmendim këtu vendimet nr.24, datë 10.11.2006, nr.1, datë 6.2.2013 dhe nr.5, datë 5.2.2014, ka interpretuar kuptimin e termave “nevojë” dhe “urgjencë”.

Bazuar në këto vendime, nevoja dhe urgjenca janë elemente me rëndësi të veçantë në përmbajtjen e nenit 101 të Kushtetutës dhe, si të tilla, janë elemente përcaktuese për të drejtën që sanksionon kjo dispozitë. Nevoja dhe urgjenca janë rrethana dhe situata fakti që vlerësohen rast pas rasti, siç është dhe garantimi i së drejtës së votës në zgjedhjet për Kuvendin, që do të zhvillohen në datën 11 maj 2025.

Në bazë të vendimeve të sipërpërmendura, Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar se prania e nevojës dhe urgjencës në kushtet e nxjerrjes së një akti normativ me fuqinë e ligjit është e lidhur me ekzistencën e vetë normës. Këtë opinion ka shprehur dhe jurisprudenca kushtetuese ndërkombëtare, duke vlerësuar se ekzistenca paraprake e nevojës dhe urgjencës përbën një kërkesë që lidhet me vlefshmërinë kushtetuese të aktit normativ që ka fuqinë e ligjit. Në rastin konkret, konsiderohet emergjent garantimi i së drejtës së shtetasve jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për moscenimin e së drejtës kushtetuese për të votuar në zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin, që do të zhvillohen në datën 11 maj 2025.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky akt normativ nuk synon përafrim me *acquis* të Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Ky akt normativ përbëhet nga 2 nene, konkretisht:

Në nenin 1 shtohet një dispozitë kalimtare me këtë përmbytje:

Afati i vlefshmërisë së pasaportave të shtetasve shqiptarë, që përfundon deri në datën 11 maj 2025, zgjatet deri në datën 31 maj 2025 për shtetasit me vendbanim jashtë vendit, votues në zgjedhjet për Kuvendin, të shpallura me dekretin nr.399, datë 5.12.2024, të Presidentit Republikës.

Kjo zgjatje e afatit të vlefshmërisë së pasaportave ka efekt vetëm për ushtrimin e së drejtës për të zgjedhur, në datën 11 maj 2025.

Në nenin 2 është parashikuar hyrja në fuqi e këtij akti normativ.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Për zbatimin e këtij akti normativ ngarkohet Ministria e Brendshme.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky akt normativ është hartuar dhe propozuar nga Ministria e Brendshme.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Akti normativ nuk shoqërohet me efekte financiare shtesë për buxhetin e shtetit.

KËSHILLI I MINISTRAVE